



European  
Union  
Kosovo

# A do të jetë Ligji i ri për Zonat Ekonomike nxitës i zhvillimit lokal?



Shkurt 2021

KOSOVO 2.0

INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE 

# A do të jetë Ligji i ri për Zonat Ekonomike nxitës i zhvillimit lokal?

Shkurt 2021

## Deklaratë mohimi:

Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe Kosovo 2.0 dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

## Përmbajtja


**3** Hyrje

**4** Zbatimi i gjertanishëm i Ligjit për zonat ekonomike

**5** Ndryshimet e propozuara në Ligjin për zonat ekonomike

**6** Gjendja aktuale në zonat ekonomike

**7** Përfundim



## Hyrje

Më 21 dhjetor 2020, Qeveria e Kosovës aprovoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zonat ekonomike.<sup>1</sup> Ky projektligj synon të rregullojë aspektet kryesore të zonave ekonomike, sikurse që është kompetenca për themelimin e tyre, mënyra e administrimit, vendndodhja e zonave, afati kohor për shfrytëzim, si dhe format për promovimin e zonave ekonomike. Sipas këtij projektligji, iniciues për themelimin e zonës ekonomike mund të jenë Zyra e Kryeministrit/es, ministritë, komunat, një grup prej dy ose më shumë të shoqërive tregtare apo të shoqatave afariste. Por, pavarësisht kush janë iniciuesit, projektligji kërkon një varg dokumentesh mbështetëse, ndër kryesoret edhe studimin e fizibilitetit apo arsyeshmërinë ekonomike.<sup>2</sup>

Por, plotësim-ndryshimi i këtij ligji ka një histori të gjatë. Ligji i parë për zonat ekonomike është aprovuar në vitin 2009<sup>3</sup> dhe pastaj është zëvendësuar me një ligj të ri në vitin 2013<sup>4</sup>. Që nga viti 2009, përmes bazës ligjore për zonat ekonomike, institucionet publike synojnë krijimin e zonave të cilat do të shërbejnë për thithjen e investimeve, krijimin e lehtësirave për bizneset, rritjen e prodhimit vendor dhe eksporteve, si dhe rritjen e punësimit.

Mirëpo, këto ligje nuk janë zbatuar në tërësi, kurse vetë zonat ekonomike nuk e kanë pasur efektin e dëshiruar. Për më tepër, vendimmarrja për krijimin e zonave ekonomike është bazuar më shumë në kritere partiake, krahinore e për qëllime elektorale, se sa në një analizë të mirëfilltë ekonomike.

<sup>1</sup> Qeveria e Kosovës. Vendimi 04/50, 21.12.2020.

Burimi: <https://bit.ly/3tZyGR>

<sup>2</sup> Qeveria e Kosovës. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-159 për Zonat Ekonomike. Burimi: <https://bit.ly/2OJK5ZO>

<sup>3</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.03/L-129 për zonat ekonomike. Burimi: <https://bit.ly/37i6vYt>

<sup>4</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.04/L-159 për zonat ekonomike. Burimi: <https://bit.ly/3jTdMmO>

## Zbatimi i gjertanishëm i Ligjit për zonat ekonomike

Ligji për zonat ekonomike synon krijimin e një infrastrukture të përshtatshme, ku përfshihet qasja më e lehtë në rrugët transportuese, furnizimi i rregullt me energji, ujë dhe lehtësira tjera, si dhe përqëndrimi i bizneseve në një vend të caktuar. Përmes kësaj infrastrukture synohet inkurajimi i investimeve, nxitja e prodhimit, zhvillimi i përgjithshëm i sektorit privat, hapja e vendeve të reja të punës dhe përshtetimi i zhvillimit rajonal.

Ligji përcakton procedurat e inicimit dhe themelimit të një zone ekonomike, duke u bazuar në një program kombëtar për zona ekonomike. Ligji themelon një komision ndërmënytor, Këshillin Kombëtar për Zonat Ekonomike, si organ këshillues për zonat ekonomike. Ky këshill nuk është takuar asnjëherë që nga viti 2014.

Në vitin 2014, Instituti GAP ka monitoruar zbatueshmërinë e Ligjit për zonat ekonomike.<sup>5</sup> Në kohën e monitorimit, ekzistonin 10 zona ekonomike në formë të parqeve të biznesit, parqe industriale apo inkubatorë të biznesit. Por, vetëm dy prej tyre ishin legalizuar dhe menaxhoheshin nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI). Probleme tjera të indentifikuara ishin edhe zvarritja e punimeve në përfundimin e infrastrukturës së nevojshme, mos profilizimi i bizneseve që operojnë brenda një zone ekonomike, stimulimet e pamjaftueshme për të bindur bizneset që të vendosen në zonën ekonomike dhe largimi i bizneseve nga zonat ekonomike për shkak të kushteve jo të favorshme të punës.

Përkundër se ka qenë obligim ligjor aprovimi i një plani kombëtar për zonat ekonomike, asnjë qeveri nuk ka aprovuar një plan të tillë. Vendimet e qeverisë për krijimin e zonave ekonomike janë bazuar vetëm në një koncept-plan 2014-2018.<sup>6</sup> Në këtë koncept-plan parashihej hartimi i një plani të detajuar strategjik deri në maj të vitit 2014, por që nuk u aprovua asnjëherë.

Po ashtu, edhe pse ka qenë kriter kryerja e studimit të fizibilitetit para krijimit të një zone ekonomike, në shumë raste kjo kërkesë nuk është respektuar nga qeveria. Në muajin mars të vitit 2014, me tri vendime të ndara, qeveria themeloi tri zona ekonomike: Komunën e Gjakovës dhe atë të Mitrovicës<sup>7</sup>, si dhe Komunën e Prizrenit<sup>8</sup>. Këto tri komuna të cilat u përzgjedhën që të jenë zona të lira ekonomike ishin komuna të qeverisura nga partitë kryesore në koalicionin qeverisës dhe vendimet më shumë ishin për qëllime elektorale se sa që kishin një arsytim ekonomik.

Për më tepër, këto vendime u morën pa prezantuar fillimisht një studim fizibiliteti, ashtu siç kërkohet me ligj. Instituti GAP ka bërë tri herë kërkesë zyrtare pranë MTI për të pasur qasje në studimin e fizibilitetit për krijimin e zonave të lira ekonomike në zonat kadastrale të Mitrovicës, Gjakovës dhe atë të Prizrenit, por nuk ka marr asnjëherë përgjigje<sup>9</sup>.

Njësoj, më 5 qershor 2018, qeveria e udhëhequr nga kryeministri Ramush Haradinaj mori vendim për themelimin e Zonës Ekonomike të Malishevës<sup>10</sup>. Njësoj si me

5 Instituti GAP. Ligji për Zonat Ekonomike: ndikimi i tij në zhvillimin e parqeve të biznesit. Maj 2014.

Burimi: <https://bit.ly/3dgsjZy>

6 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Koncepti i Planit Kombëtar për Zhvillimin e Zonave Ekonomike në Kosovë 2014-2018. Burimi: <https://bit.ly/3plm8ob>

7 Qeveria e Kosovës. Vendimet 02/178 dhe 03/178. Datë 18.03.2014. Burimi: <https://bit.ly/3b5pqa5>

8 Qeveria e Kosovës. Vendimet 01/180. Datë 28.03.2014. Burimi: <https://bit.ly/3rY7QvE>

9 Kërkesa e parë është bërë më 4 prill 2014, përsëritja e kërkesës është bërë më 14 prill dhe e fundit më 22 prill 2014, por nuk ka marr përgjigje asnjëherë. Burimi: Instituti GAP. Paqartësitë në krijimin e zonave të lira ekonomike. 28 maj 2014. Burimi: <https://bit.ly/2ZkhSul>

10 Qeveria e Kosovës. Vendimi 11/50. Datë 05.06.2018. Burimi: <https://bit.ly/3akEm4V>

zonat e lira ekonomike në Gjakovë, Mitrovicë dhe Prizren, edhe ky vendim ishte i motivuar politikisht, ngase Zona Ekonomike e Malishevës ishte propozuar nga ministri i MTI-së, që vinte nga partia NISMA, e njëjtë me atë që udhëheq Komunën e Malishevës, si dhe një pjesë e zonës ekonomike do të shtrihej në zonat kadastrale në fshatin prej nga kishte prejardhjen kryetari i partisë.

Vendimet për themelimin e Zonës Ekonomike të Malishevës u shfuqizuan në fillim të vitit 2020<sup>11</sup> nga qeveria e udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti. Zona Ekonomike e Malishevës u anulua me arsyetimin se qeveria paraardhëse kishte marr vendim në kundërshtim me Ligjin për zonat ekonomike. Kjo zonë nuk kishte studim fizibiliteti, nuk ishte paraparë me koncept-planin për zonat ekonomike, nuk ishin mbajtur dëgjime publike, dhe parashihej të shtrihej në prona private, të cilat ishin privatizuar më herët me çmim prej 10 euro për ari dhe tash po shpronësoheshin me 807 euro ari.<sup>12</sup>

## Ndryshimet e propozuara në Ligjin për zonat ekonomike

Më 7 prill 2017, qeveria ka aprovuar Koncept Dokumentin për Fushën e Zonave Ekonomike.<sup>13</sup> Në këtë dokument identifikohen problemet kryesore në zbatimin e Ligjit për zonat ekonomike. Sipas këtij dokumenti, këto janë sfidat kryesore në zbatimin e ligjit:

- Konfuzion ligjor ndërmjet nivelit lokal dhe qendror lidhur me të drejtat për krijimin e zonave ekonomike;
- Mos definimi konkret se çka nënkuptohet me emërtimin “zonë e lirë” ekonomike;
- Mungesa e afateve kohore për fillimin e aktiviteteve në zonën ekonomike;
- Panevojshmëria e ekzistimit të Këshillit Kombëtar për Zonat Ekonomike;
- Procedura të shumta burokratike për marrjen e lejeve për zonat ekonomike;
- Zonat ekonomike nuk janë të ndara në bazë të veprimtarive ekonomike;
- Nuk ofrohen lehtësira me qëllim që zonat ekonomike në Kosovë të jenë konkurruese me zonat ekonomike në vendet e rajonit.

Projektligji i ri i aprovuar në qeveri zëvendëson pjesën më të madhe të ligjit aktual dhe si i tillë do të duhej të aprovohej si ligj i ri e jo si plotësim-ndryshim të ligjit në fuqi. Projektligji zëvendëson në tërësi apo fshin 10 nga 25 nenet e ligjit aktual dhe këto 10 nene të reja janë pjesë kryesore e ligjit, shtohen dy nene të reja dhe ndryshohen pesë nene.

Ndryshimet e propozuara në Ligjin për zonat ekonomike kanë të bëjnë me procedurat e themelimit të një zone ekonomike dhe menaxhimin e këtyre zonave. Ndryshimi më i madh ka të bëjë me atë se inicuesit e zonave ekonomike dhe themeluesit nuk kanë për detyrim që të marrin edhe pëlqimin e Doganës së Kosovës, çfarë nënkupton se bizneset në zona ekonomike nuk do të kenë lehtësira doganore. Me ndryshimet e propozuara, komunave u hiqet e drejta e themelimit të zonave ekonomike, por vetëm kanë të drejtë të inicimit të kërkesës pranë MTI-së.

Me ndryshimet e reja parashihet shuarja e Këshillit Kombëtar për Zonat Ekonomike dhe largimi i detyrimit të qeverisë për të aprovuar një plan kombëtar për zonat ekonomike.

11 Qeveria e Kosovës. Vendimi 03/15. Datë 23.03.2020. Burimi: <https://bit.ly/3bajEUD>

12 Ibid.

13 Qeveria e Kosovës. Vendimi 04/141. Datë 07.04.2017. Burimi: <https://bit.ly/3rVjPKm>

## Gjendja aktuale në zonat ekonomike

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, është përgjegjëse për menaxhimin e zonave ekonomike. KIESA njofton investitorët potencial për legjislacionin për zona ekonomike, ofron informata për infrastrukturën fizike në kuadër të zonave ekonomike, pranon dhe shqyrton aplikacionet për zona ekonomike, shqyrton ankesat e bizneseve dhe promovon zonat ekonomike.

Sipas të dhënave të publikuara nga KIESA, deri më tani janë themeluar 10 zona ekonomike dhe tri zona të lira ekonomike.

**Tabela 1. Zonat ekonomike në Kosovë**

Viti i krijimit	Zona ekonomike	Loji i veprimtarisë	Numri i bizneseve	Hapësira (ha)
2010	Parku i Biznesit në <b>Drenas</b>	Prodhime farmaceutike, prodhimin e liftave, metalpunues, sektori i drurit, riciklimi i plastikës.	41	24
2012	Parku i Biznesit në <b>Mitrovicë</b>	Riciklimi i plastikës, zdrukhtaria, tekstili, prodhimi i thasëve të letrës, prodhime metalike, etj.	24	3.5
2013	Parku Teknologjik në <b>Shtime</b>	Konservimi i perimeve, prodhimi i shtyllave elektrike nga betoni, prodhimi i pllakave nga kuarci dhe mermeri, përpunimi i xhamave, etj.	10	10.7
2014	Parku Industrial në <b>Mitrovicë</b>	Kontrata të nënshkruara me biznese për tu vendosur veprimtraia e të cilave përfshinë: prodhimin e mobileve, prodhimin e ngjyrave dhe ngjitësve, prodhimin e dyerve nga druri, përpunimin e mbetjeve medicinale etj.	1	48
2015	Zona Agro-Industriale në <b>Suharekë</b>	Ende nuk është arritur finalizimi i ndërtimit të infrastrukturës fizike për të u vendosur bizneset	-	28
2016	Parku Industrial në <b>Lipjan</b>	Nuk kanë përfunduar ende punimet	-	56
2017	Parku Industrial në <b>Suharekë</b>	Bizneset që janë të vendosura ushtrojnë veprimtari të ndryshme si p.sh. prodhimin e këpucëve, fasadave, përpunues i pijeve freskuese, prodhimin e elementeve nga betoni, përpunim dhe konservim të perimeve, përpunimin e mermerit dhe granitit etj.	-	162
2017	Parku Industrial në <b>Viti</b>	janë duke vazhduar investimet në ndërtimin e infrastrukturës fizike për vendosjes së bizneseve në këtë park.	-	15.5
2018	Parku Industrial në <b>Vushtrri</b>	Në vitin 2019 ka filluar investimet në Ndërtimin e infrastrukturës fizike për vendosjes së bizneseve në këtë park.	-	14.86
-	Zona Ekonomike në <b>Opterushë - Rahovec</b>	Mungojnë të dhënat.	-	-

Burimi: KIESA, 2021

Përveç këtyre zonave ekonomike, janë themeluar edhe tri zona të lira ekonomike:

- Zona e Lirë Ekonomike e **Gjakovës**
- Zona e Lirë Ekonomike e **Mitrovicës**
- Zona e Lirë Ekonomike e **Prizrenit**

Për këto tri zona të lira ekonomike ekzistojnë vendimet zyrtare, por nuk ka ndryshuar asgjë në praktikë. Për më tepër, me ndryshimet e propozuara në Ligjin për zonat ekonomike, parashihet largimi i emërimit “zonë e lirë” dhe me këtë largohen edhe benefitet që parashihen për zonat e lira sipas Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Sipas Kodit Doganor dhe të Akcizave, zonat e lira dhe depot e lira janë pjesë të Kosovës apo ambiente të vendosura në Kosovë apo të ndara nga pjesa tjetër, në të cilat:

- a. “Mallrat jo-kosovare, për qëllim të zbatimit të detyrimeve të importit dhe të masave të politikës tregtare të importit, konsiderohen sikur nuk ndodhen në Kosovë, me kusht që të mos jenë vendosur në qarkullim të lirë ose të mos jenë vendosur nën një procedurë tjetër doganore dhe nuk janë përdorur apo konsumuar në kushte të ndryshme nga ato të parashikuara me legjislacionin doganor;
- b. Mallrat kosovare, për të cilat janë sjell dispozitat e veçanta sipas legjislacionit Kosovar, të cilat për shkak të vendosjes në një zonë të lirë ose depo të lirë, përfitojnë nga masat që normalisht shoqërojnë eksportimin e mallrave.”<sup>14</sup>

Në proces është edhe zgjerimi i Parkut Industrial të Drenasit me një hapësirë shtesë prej 60 hektarë.

Së paku katër komuna kanë aplikuar në KIESA për të themeluar zona të reja ekonomike: Malisheva, Istogu, Ferizaj dhe Dragashi. Në zgjedhjet e fundit lokale, së paku 11 krytar aktual komunash dolën me premtime për krijimin e zonave të reja ekonomike.<sup>15</sup>

## Përfundim

Përkundër asaj se baza ligjore për themelimin e zonave ekonomike ekziston që nga viti 2009, përgjatë gjithë kësaj periudhe ka pasur paqartësi ligjore dhe konflikt kompetencash për themelimin e zonave ekonomike. Edhe pse me Kodin doganor dhe të akcizave parashihet krijimi i zonave të lira ekonomike dhe qeveria ka themeluar tri zona të tilla, nuk ka ekzistuar asnjë veprim praktik për funksionalizimin e këtyre zonave.

Vendimet qeveritare për themelimin e zonave ekonomike më shumë kanë qenë të motivuara politikisht, se sa të bazuara në studime dhe analizë të të mirave (cost-benefit) të ekzistimit të tyre. Po ashtu, qeveria ka shfrytëzuar zonat ekonomike edhe si mjet për shpronësime të pronave private për përfitime të grupeve të caktuara. Punimet në finalizimin e infrastrukturës në zona ekonomike kanë zgjatur për shumë vite dhe shumë biznese kanë prishur kontratat për tu vendosur në këto zona për shkak të zvarritjes së punimeve.

Edhe pse mbi 76 biznese janë vendosur në këto zona dhe zonat ekonomike zënë së paku 422.5 hektarë hapësirë, nuk ka një analizë të detajuar të përfitimeve ekonomike, rritjes së investimeve dhe punësimit.

Ndryshimet e propozuara në Ligjin për zonat ekonomike, përveç qartësimin të procedurave ligjore, prapë se prapë nuk ofrojnë incentiva të mjaftushme për ndërmarrjet që vendosen në zonat ekonomike.


<sup>14</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Kodi nr.03/L-109 doganor dhe i akcizave në Kosovë. Burimi: <https://bit.ly/2NwGZYA>

<sup>15</sup> Kryetarët e komunave të cilët premtuan zona ekonomike gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2017: Dragash, Ferizaj, Istog, Junik, Lipjan. Podujeve, Prizren, Rahovec, Shtime, Vit, Vushtrri. Burimi: <https://bit.ly/3qyidFR>



European  
Union  
Kosovo

Projekti “Inovacioni për mediat e  
qëndrueshme dhe angazhimin qytetar”  
i financuar nga BE, implementohet nga:



A do të jetë Ligji i ri për Zonat Ekonomike  
nxitës i zhvillimit lokal?